




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep. <u>20/DPK</u> Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages <u>02</u>	Nr Prot. Br.Prot. Prot No <u>01-863/14</u> Data Datum Date <u>13.03.2014</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 12.03.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-247/14 për znj. *Drita Begolli – Anëtare e Këshillit të Pavarur për Media dhe Prorektore në Universitetin “Haxhi Zeka” Pejë, për shkak se znj. Begolli ka dhënë dorëheqje nga të qenurit Anëtare e Komisionit të Pavarur për Media, me çka kashmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-247-14, për Zyrtaren e lartë, znj. Drita Begolli–Prorektore në Universitetin publik “Haxhi Zeka” të Pejës dhe njëkohësisht Anëtare e Komisionit të Pavarur për Media, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).

Zyrtarja e lartë, znj.Drita Begolli fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit (AKK), pas të cilës ajo është paraqitur në AKK, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shhangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtarja e lartë, znj.Begolli, ka dekluaruar se ajo tashmë ka ofruar dorëheqje nga të qenurit Anëtare e Komisionit të Pavarur për Media (shkresa zyrtare me nr.prot.DPKI-03-612/14) dhe që nga kjo kohë nuk e ushtron më funksionin e saj si Anëtare e Komisionit të Pavarur për Media.

Ndërkohë, znj.Begolli, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë shkresën zyrtare nga Komisioni i Pavarur për Media (KRK-1/2-04/02/2014) në të cilën shihet se znj. Drita Begolli ka dhënë dorëheqje nga pozita, e cila është aprovuar nga nëpunësi i autorizuar në KPM.

Znj.Drita Begolli vazhdon të ushtroj funksionin e saj publik, si Prorektore e Universiteti Publik “Haxhi Zeka” të Pejës.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtoret të DPK-së
- Z./znej. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znej. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

